



Duke u mbështetur në nenin 73 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 28 të Statutit të Komunës së Klinës si dhe nenit 5,6 dhe 7 të Rregullores Komunale për Komitete Konsultative/2012, si dhe Vendimit për Shpallje të Konkursit publik për anëtarësimin në Komitete Konsultative me numër 01Nr.06-10163 të miratuar me 25.03.2022, Konkursit 01.Nr.06-37187 të datës 31.10.2022 dhe sipas Propozimit të Listës së ngushtë të Panelit Intervistues për kandidatët për anëtarësim në komitete Konsultative të Komunës së Klinës të datës 14.12.2022, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e XI-të të radhës për vitin 2022, të mbajtur më 20.12.2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet, lista e propozuar e panelit intervistues për anëtarësim në Komitetin Konsultativ të Kuvendit të Komunës së Klinës

Në Komitetin për Bujqësi, zhvillim rural dhe mbrojtje të mjedisit zgjedhën:

1. Dijesa Morina
2. Artur Morina
3. Ermelinda Berisha
4. Luan Berisha
5. Rinor Sejdiu

2. Organizimi, funksionimi si dhe kompetencat e këtij Komiteti janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, Nr. 03/L-040, Statutit të Komunës, Rregullores komunale për komitete Konsultative, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016.

3. Mandati i anëtarëve të komiteteve konsultative është 4 vjeçar nga themelimi i komitetit dhe nuk mund të shërbeje me shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

4. Komuna është e obliguar të ofrojë në dispozicion mjetet e nevojshme në mënyrë që komiteti të këtë mundësi të kryej punën në mënyrë efikase.

5. Komitetet mbajnë se paku gjashtë (6) takime në vit dhe kompensohen nga buxheti i komunës jo me shumë se për gjashtë (6) takime në vit.

6.Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin në Kuvendin e Komunës së Klinës konform nenit 81 të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale.

7.Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari, anëtarët e Komiteteve Konsultative, Zyra Ligjore, Zyra e Informimit, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 060-42825 2022
Klinë, më 23.12 2022



KRYESUESI,
Fadil Gashi